VENDIM
Nr. 71, datë 15.10.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Ilir Toska	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 15.10.2024, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 9 (Sh) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Prend Suta, përfaqësuar nga avokat Preng Frroku, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm Astrit Hado.

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Shkodër, përfaqësuar nga drejtoresha Violeta Staka.

AVOKATURA E SHTETIT, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 182 (359), datë 6.7.2020, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër; nr. 379 (86-2023-549), datë 11.5.2023, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2023-5403, datë 4.12.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 33, 43, 44, 52, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 31 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Institutit të Sigurimeve Shoqërore (*ISSH*) dhe Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (*DRSSH*), Shkodër, të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Prend Suta i është drejtuar DRSSH-së, Shkodër me kërkesë për lidhjen e pensionit të veçantë si punonjës nëntoke, bazuar në dispozitat e ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë" (*ligji nr. 8685/2000*). Bazuar në këtë ligj, me vendimin nr. 9, datë 18.7.2001, DRSSH-ja, Shkodër i ka caktuar kërkuesit trajtimin e veçantë si punonjës në nëntokë për një periudhë sigurimi 30 vjet e 9 muaj, nga të cilat 12 vjet si punonjës në minierë, në nëntokë, me datë fillimi të përfitimit 16.12.2000.

2. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 150/2014, datë 6.11.2014, "Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë" (*ligji nr. 150/2014*), kërkuesi ka paraqitur kërkesë për pension pleqërie të kategorisë së parë sipas parashikimeve të këtij ligji. DRSSH-ja, Shkodër, me vendimin nr. 125, datë 27.2.2015, ka refuzuar kërkesën për pension pleqërie të kategorisë së parë, përveçse ka vendosur edhe mbylljen e trajtimit të veçantë që kërkuesi përfitonte sipas ligjit nr. 8685/2000, duke e deklaruar atë debitor për shumën 1,060,448 lekë, me argumentin se kërkuesi nuk plotësonte kushtet për përfitimin e pensionit të pleqërisë së kategorisë së parë dhe as ato për trajtimin e veçantë si punonjës në minierë në nëntokë, konkretisht atë të periudhës së sigurimit (vjetërsisë në punë). Duke mos qenë dakord me vendimin e DRSSH-së, Shkodër, kërkuesi ka paraqitur ankim pranë Komisionit Rajonal të Ankimit Shkodër, i cili, me vendimin nr. 116, datë 23.4.2015, ka vlerësuar se nuk ka kompetencë për shqyrtimin e kërkesës, pasi përfitimi i kërkuar nuk është objekt i ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 7703/1993*). Me të njëjtin arsyetim, me vendimin nr. 635, datë 20.7.2015, edhe Komisioni Qendror i Ankimit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore (*ISSH*), ka vendosur të mos shqyrtojë ankimin e kërkuesit, duke vlerësuar se nuk përbën objekt shqyrtimi sipas nenit 86, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 7703/1993.

3. Kërkuesi, duke mos qenë dakord me këto vendime, i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimeve nr. 125, datë 27.2.2015, të DRSSH-së, Shkodër, nr. 116, datë 23.4.2015, të Komisionit Rajonal të Ankimit dhe nr. 635, datë 20.7.2015, të Komisionit Qendror të Ankimit pranë ISSH-së, detyrimin e palës së paditur, DRSSH-së, Shkodër, të bëjë rilidhjen e pensionit të plotë dhe pagimin e tij që nga momenti i ndërprerjes datë 27.2.2015 e në vazhdim, si dhe anulimin e masës debitor prej 1,060,448 lekësh.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, me vendimin nr. 182 (359), datë 6.7.2020, ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në prova dhe në ligj, vendim i cili, pas ankimimit të tij nga kërkuesi, është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 379 (86-2023-549), datë 11.5.2023. Për rekursin e kërkuesit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-5403, datë 4.12.2023, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se nuk plotëson kushtet paraprake të pranueshmërisë, pasi shkaqet në rekurs nuk mbështeten në asnjë nga rastet e parashikuara në nenin 58, të ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" (*ligji nr. 49/2012*).

5. Në datën 18.3.2024, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 29.3.2024.

6. Me vendimin e datës 14.5.2024, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar:

7.1 *E drejta për proces të rregullt*, në drejtim të:

7.1.1 Së drejtës për t'u dëgjuar para se të gjykohet, në kuptim të nenit 33 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, pasi vendimi në Gjykatën e Lartë është marrë në dhomën e këshillimit, pa u dëgjuar palët (kërkuesi) edhe pse ato kanë të drejtë të jenë të pranishme në seancë dhe të përfaqësohen me avokat.

7.1.2 Standardit të arsyetimit, në kuptim të nenit 142 të Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë nuk ka shqyrtuar pretendimet në rekursin e kërkuesit, ndërsa vendimin e saj e ka bazuar në pretendimet dhe të dhënat e një personi tjetër.

7.2 *E drejta për zhdëmtim*, në kuptim të nenit 44 të Kushtetutës, për shkak të mohimit të provave shkencore, siç është akti i ekspertimit i Policisë Gjyqësore, në kundërshtim edhe me nenet 228, 253 dhe 254 të Kodit të Procedurës Civile, për sa kohë që kërkuesi ka përfituar pension për vitet e punës në ndërmarrjen gjeologjike dhe nga DRSSH-ja i janë hequr këto vite.

7.3 *E drejta për pension,* në kuptim të nenit 52 të Kushtetutës, pasi kërkuesi ka disa vite punë dhe nuk përfiton pension pleqërie.

8. ***Subjektet e interesuara, DRSSH-ja, Shkodër dhe ISSH-ja,*** kanë prapësuar, në mënyrë të përmbledhur, të njëjtat shkaqe si vijon:

8.1. Vendimet e kundërshtuara janë marrë në zbatim dhe interpretim të drejtë të ligjit procedural dhe material, pas një procesi të rregullt. Shkaqet e parashtruara nga kërkuesi nuk qëndrojnë, pasi ai nuk vërteton dot vjetërsinë në punë në Ndërmarrjen Gjeologjike Pukë për periudhat e pretenduara, çka rezulton edhe nga vendimi i dhënë në procesin penal ndaj tij.

8.2. Pretendimet lidhur me ligjshmërinë e akteve administrative të kundërshtuara dhe faktet e provuara në proces nuk mund të bëhen sërish objekt shqyrtimi, pasi përbëjnë gjë të gjykuar në kuptim të ligjit, për sa kohë janë gjykuar më parë në procesin gjyqësor të përmbyllur me vendimin nr. 2919, datë 6.11.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

8.3. Vendimet objekt gjykimi nuk janë marrë në kundërshtim me parimet e procesit të rregullt, pasi palët kanë pasur të drejtë të paraqesin dhe të mbrojnë qëndrimet e tyre në zbatim të drejtë të ligjit procedural dhe material.

9. ***Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit,*** nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

10. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae,* në kuptim të shkronjës "f", të pikës 1, të nenit 131 dhe shkronjës "i", të pikës 1, të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

12. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për sa i përket procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, kërkuesi nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

13. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit i kundërshtuar, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 4.12.2023, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 18.3.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

14. Për sa i përket legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar si cenimin e së drejtës për proces të rregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, në aspektin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, ashtu edhe të së drejtës për zhdëmtim dhe asaj për pension, në kuptim të neneve 44 dhe 52 të Kushtetutës. Duke pasur parasysh natyrën dhe përmbajtjen në thelb të pretendimeve të kërkuesit, Gjykata vlerëson t'i shqyrtojë ato në këndvështrim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e ankimit.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e ankimit

15. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë e ka bazuar vendimin e saj në pretendimet dhe të dhënat e një personi tjetër dhe, për rrjedhojë, nuk ka shqyrtuar pretendimet e ngritura nga kërkuesi në rekurs dhe nuk u ka dhënë përgjigje atyre, duke mos e arsyetuar vendimin e saj.

16. Subjektet e interesuara, DRSSH-ja, Shkodër dhe ISSH-ja, kanë prapësuar, në thelb, se pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara dhe se vendimet e kundërshtuara janë marrë në zbatim dhe interpretim të drejtë të ligjit procedural dhe material, pas një procesi të rregullt ligjor, ndërsa palët kanë pasur mundësi të paraqesin dhe të mbrojnë qëndrimet e tyre.

17. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 11, datë 10.3.2023; nr. 22, datë 29.9.2022; nr. 6, datë 16.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimet nr. 11, datë 10.3.2023; nr. 22, datë 29.9.2022; nr. 19, datë 1.4.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë, Gjykata është shprehur se ato mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit dhe se ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit *(shih vendimet nr. 10, datë 7.3.2023; nr. 21, datë 16.4.2015; nr. 37, datë 19.9.2011, të Gjykatës Kushtetuese).*

18. Kurse për sa i përket së drejtës së ankimit, sipas nenit 43 të Kushtetutës, ajo vlerësohet si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar atij (individit) të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj. Çdo instancë ankimuese që njeh sistemi i normave procedurale civile/penale është pjesë e së drejtës së individit për të pasur akses në gjykatë (*shih vendimet nr. 45, datë 3.7.2017; nr. 24, datë 25.4.2016; nr. 38, datë 30.6.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar, gjithashtu, se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 9, datë 27.2.2024; nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 71, datë 13.11.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Duke pasur parasysh standardet e mësipërme, në referim të përmbajtjes së pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi, Gjykata do të ndalet në vijim në vlerësimin nëse vendimi i Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit përmbush standardet kushtetuese të arsyetimit, me qëllimin për të verifikuar nëse mënyra se si ajo gjykatë ka vlerësuar çështjen e kërkuesit ka respektuar të drejtën e tij kushtetuese të ankimit në një gjykatë më të lartë.

21. Gjykata vëren se kërkuesi, pasi ka shteruar rrugën administrative për kundërshtimin e vendimit të DRSSH-së, Shkodër, për refuzimin e kërkesës për pension pleqërie të kategorisë së parë, përveçse mbylljes së trajtimit të veçantë për të dhe deklarimit debitor, ka vënë në lëvizje gjykatën duke i kundërshtuar aktet administrative me pretendimin për pavlefshmërinë absolute të tyre, ndërsa ka kërkuar, krahas konstatimit të tyre si absolutisht të pavlefshme, edhe detyrimin e palës së paditur, DRSSH-së, Shkodër, t'i rilidhë pensionin e plotë dhe ta paguajë që nga momenti i ndërprerjes datë 27.2.2015 e në vazhdim, si dhe anulimin e shpalljes debitor në masën 1,060, 448 lekë. Gjykata administrative e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në prova dhe në ligj, duke parashtruar argumentet e saj për mungesën e kushteve që çojnë në pavlefshmërinë absolute të akteve administrative objekt gjykimi, sikundër edhe për ligjshmërinë e tyre, gjë e cila përbënte gjë të gjykuar, ndërsa ajo ishte vlerësuar në një proces tjetër gjyqësor të përmbyllur me vendimin nr. 2919,

datë 6.11.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit. Mbi të njëjtin arsyetim, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë.

22. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, duke parashtruar si shkaqe, në mënyrë të përmbledhur, se: ai ka përfituar pension si minator nëntoke në Ndërmarrjen Gjeologjike Pukë dhe në fletën e regjistrit nuk ka pasur ndërhyrje; vendimi i DRSSH-së, Shkodër është absolutisht i pavlefshëm, pasi është shkelur neni 116 i Kodit të Procedurave Administrative; në kuptim të nenit 44 të Kushtetutës kërkuesi ka të drejtë të rehabilitohet dhe të zhdëmtohet në përputhje me ligjin për shkak se është dëmtuar nga akti i paligjshëm i DRSSH-së, Shkodër me të cilin është penalizuar nga e drejta e pensionit, si e vetmja formë për të siguruar minimumin jetik; nga akti i ekspertimit grafik nr. 8841, datë 9.9.2015, ka rezultuar se në regjistrin nr. 205 të Parkut të Automjeteve Pukë konstatohen ndërhyrje, ndërsa në regjistrin nr. 341 të Ndërmarrjes Gjeologjike Pukë nuk ka ndërhyrje; këto regjistra janë plotësuar nga administrata shtetërore; vendimet janë marrë në interpretim të gabuar të ligjit; në kuptim të nenit 52 të Kushtetutës kërkuesi ka të drejtën e pensionit të pleqërisë, i cili i është mohuar dhe ai ka mbetur pa mjete jetese që prej vitit 2015 e në vijim; në rastin konkret kemi të bëjmë me objekte të ndryshme dhe pavlefshmëria e aktit nuk është gjë e gjykuar.

23. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se nuk ngre asnjë shkak nga ato që parashikohen në nenin 58, të ligjit nr. 49/2012. Në përmbajtjen e vendimit të asaj gjykate, si shkaqe të rekursit të kërkuesit janë pasqyruar se: pretendimi i paditësit për vjetërsinë në punë pranë Qendrës Ekonomike të Arsimit Dibër, periudha 6.3.1978–31.12.1979, ishte i vërtetë dhe duhej të merrej për bazë për efekt llogaritjeje të masës së pensionit të invaliditetit; kjo periudhë pune ishte e dokumentuar në librezën e punës së paditësit dhe nga palët e paditura nuk ishin kundërshtuar këto regjistrime si të pasakta dhe duhet të merreshin për bazë në llogaritjen e masës së pensionit; pala e paditur në rastin e mosmarrjes parasysh të kësaj vjetërsie në punë, është e detyruar të provojë parregullshmërinë e librezës së punës; paditësi ka shprehur qartë në ankim se për të zgjidhur çështjen në mënyrë të drejtë ishte e domosdoshme kryerja e një ekspertimi nga një specialist i fushës; gjykata e apelit nuk shpalli datën e gjykimit, duke i hequr mundësinë paditësit që të paraqiste prova dhe pretendime shtesë; gjykata e apelit, ashtu si dhe shkalla e parë, mori si të vërteta pretendimet e palës së paditur; gjatë gjykimit në shkallë të parë, palët e paditura pretenduan se vjetërsia në punë e paditësit e dokumentuar në librezën e punës, në ish-Qendrën Ekonomike të Arsimit Dibër, nuk konfirmohej me dokumente dhe për këtë arsye nuk e kanë marrë për bazë në llogaritjen e pensionit ndaj nevojitej të merrej një ekspert i fushës; pensioni i llogaritur nga pala e paditur është më i vogël nga sa i takon sipas llogaritjeve të bëra nga eksperti i ngarkuar nga paditësi.

24. Gjykata, referuar përmbajtjes së rekursit të paraqitur nga kërkuesi bashkëlidhur kërkesës, por edhe vetë përmbajtjes së vendimit të Gjykatës së Lartë, konstaton se shkaqet e paraqitura në vendimin e asaj gjykate qartazi nuk kanë lidhje me çështjen e kërkuesit dhe as me faktet që kanë rezultuar gjatë procesit gjyqësor në gjykatat e faktit apo që kërkuesi pretendon se janë provuar gjatë atij procesi. Shkaqet që janë parashtruar nga Gjykata e Lartë në vendimin e saj dukshëm kanë të bëjnë me një çështje tjetër, të ndryshme nga ajo e kërkuesit. Për rrjedhojë, në prani të këtij fakti, Gjykata vëren se kjo është një e metë në vendimin e Gjykatës së Lartë, që vë në dyshim standardin e arsyetimit të atij vendimi, përderisa në arsyetimin e kufizuar të tij, në pjesën hyrëse të vendimit, nuk listohen shkaqet e rekursit të kërkuesit, çka vë në dyshim vlerësimin e asaj gjykate gjatë shqyrtimit paraprak të tij dhe përfundimet e arritura nga ajo në lidhje me shkaqet e mospranimit të rekursit, për rrjedhojë edhe ushtrimin efektiv të së drejtës së ankimit të kërkuesit në një gjykatë më të lartë.

25. Kjo e metë e konstatuar në vendimin e Gjykatës së Lartë është e tillë që cenon në tërësi standardin e arsyetimit të vendimit të lidhur me të drejtën e ankimit, për sa kohë që nuk i lejon Gjykatës të arrijë në një përfundim të drejtë nëse Gjykata e Lartë, në përputhje me funksionin e saj dhe në zbatim të parimit të subsidiaritetit, i ka marrë në shqyrtim shkaqet e parashtruara nga kërkuesi në rekurs dhe nëse përfundimi në lidhje me (pa)bazueshmërinë e tyre është rrjedhojë e analizës së këtyre shkaqeve.

26. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt, në aspektin e standardit të arsyetimit të lidhur me të drejtën e ankimit, është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të vendimit, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

27. Për sa u përket pretendimeve të tjera të ngritura nga kërkuesi, Gjykata vlerëson se, bazuar në parimin e subsidiaritetit, është detyrë e Gjykatës së Lartë që t'i vlerësojë dhe t'u japë atyre përgjigje në përputhje me funksionin e saj si gjykatë ligji, gjatë shqyrtimit të shkaqeve të rekursit mbi bazën e të cilit ajo është vënë në lëvizje.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-5403, datë 4.12.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 15.10.2024.
Shpallur, më 13.11.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahimi, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Marjana Semini